



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 77, Datë 19.03.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURES PER SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SH.A.,
PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË SHLYERJES PËR
SHKËMBIMIN E ENERGJISË NË PËRPUTHJE ME NENET 50 (3) DHE 51 (1) TË
KOMISIONIT RREGULLATOR TË BASHKIMIT EVROPIAN 2017/2195”**

Në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 55, pika 3, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 15, 19 dhe 26, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 37/4 prot., datë 17.03.2021 të Drejtorive Teknike, mbi shqyrtimin e kërkesës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) për miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”,

Konstatoi se:

- OST sh.a., përmes shkresës nr. 4957 prot., datë 14.08.2020, ka përcjell pranë ERE për miratim “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, të datës 23 Nëntor 2017, i cili krijon një udhëzim për balancimin e energjisë elektrike.
- ERE përmes shkresës nr. 1054/1 prot., datë 11.09.2020, drejtuar OST sh.a., ndër të tjera ka evidentuar, se përkthimi nga gjuha angleze duhet të rishikohet, si dhe nisur nga situata aktuale dhe e mëparshme të shihet nëse OST sh.a., ka bërë një vlerësim të kostove financiare që do të ketë nga aplikimi i mekanizmit të propozuar. Një kërkesë e tillë është e domosdoshme për vlerësimin e mundësive të mbulimit të kostove që do të vijnë nga ky proces.
- Në vijim të komunikimit, OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 4957/3 prot., datë 26.10.2020, ka bërë me dije se e ka rishqyrtuar materialin dhe e ka ridërguar në ERE.
- ERE nëpërmjet shkresës nr. 298 prot., datë 11.02.2021, ka kërkuar nga OST sh.a., të japë informacionin dhe sqarimet përkatëse lidhur me dokumentacionin e paraqitur në mënyrë që të mund të ezauroheshin të gjithë elementët e pa trajtuar nga komunikimi i mëparshëm nëpërmjet shkresës nr. 1054/1 prot., datë 11.09.2020. Ndër të tjera në këtë shkresë, është kërkuar të qartësohet nga OST sh.a., nëse kërkohet të miratohen vetëm propozimet e OST-ve kontinentale apo kërkohet të miratohet dhe shpjeguesi i dërguar nga OST sh.a., si pjesë e dokumenteve për miratim. Gjithashtu, është kërkuar të shihet mundësia për të kontaktuar me ENTSO-E, nëse kanë kryer ndonjë simulim ose të përcillet në ERE vlerësimi i vetë

OST sh.a., lidhur me parashikimet e kostove të mundshme që mund të ketë operatori lidhur me aplikimin e mekanizmit të ri të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë së propozuar”.

- Lidhur me sa kërkuar nga ERE me shkresën sipërcituar, OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1171/1 prot., datë 22.02.2021, ndër të tjera ka parashtruar si më poshtë vijon:
 - *Shpjeguesi për propozimin e bërë mbi rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, është dokument shoqërues me qëllim dhënien e detajeve të mëtejshme ezauruese, për të gjithë propozimet e OST-ve të Evropës Kontinentale për rregullat e Përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me Nenin 50(3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator (BE) 2017/2195, të datës 23 Nëntor 2017. Në këto kushte shpjeguesi për propozimet e bëra, nuk është pjesë e dokumenteve për miratim.*
 - *Ne këtë moment, OST sh.a. nuk disponon ndonjë vlerësim financiar për mekanizmin e propozuar, pasi as grupi i punës i ngritur nga ENTSO-E për implementimin e tij, nuk ka kryer simulime për të parë efektet financiare që mund të ketë çdo OST. Gjithsesi, në përgjigje edhe të kërkesës suaj për të përcjellë kostot e mundshme, sqarojmë se këto kosto do mbuloohen nga mekanizmi balancues, pra çdo PPB do paguajë për disbalancat e paqëllimshme të krijuara duke injektuar ose tërhequr energji nga interkoneksioni. Në vlerësimin tonë dhe në analizë të mekanizmit, mund të ketë kosto të pritshme që duhet t'i mbulojë OST, kjo për faktin që çmimi që do të rezultojë nga zbatueshmëria e rregullave tona të mekanizmit balancues mund të jetë i ndryshëm nga çmimi i shlyerjes për çdo TSO, sipas llogaritjeve të bëra nga qendra koordinative, në përputhje me termat e Marrëveshjes. Në këto kushte dhe për sa shprehur me sipër këto kosto të mundshme do të vlerësohen më qartë gjatë 6 mujorit të parë të aplikimit të kompensimit të devijimeve të paqëllimshme në interkoneksion, që nuk do të jenë më në natyrë, por palët (TSO-të) do të kompensojnë njëra - tjetrën financiarisht.*
- “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenin 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, të datës 23 Nëntor 2017, përbëhen nga:

- 1. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.**

Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale, në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

- 2. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3), i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të**

23 Nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Ky dokument gjithashtu është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) në përputhje me Nenin 50 (3), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike. Ky mekanizëm do të përdoret si një mekanizëm i përbashkët i shlyerjes së devijimeve për Evropën Kontinentale për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje).

- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 55, pika (3) përcakton se: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe parashikimeve të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal”*.
- Duke marrë në konsideratë detyrimet që OST sh.a., ka si palë e ENTSO-E, si dhe faktin që ky mekanizëm i propozuar është një mekanizëm që është dakordësuar nga gjithë OST-të në Evropën kontinentale, anëtarë të ENTSO – E, për rrjedhojë nuk mund të ndryshojë pasi është mekanizëm i përbashkët që afekton gjithë OST-të anëtare të ENTSO - E.
- Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195, priten të aplikohen nga OST e Evropës kontinentale anëtarë të ENTSO – E, që nga data 1 Qershor 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195, të përberë nga:
 - I. Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të pa qëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike
 - II. Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3), i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë OST sh.a., dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI